

VENDIM
Nr. 26, datë 30.1.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ENERGJI ASHTA SHPK NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1, germa “d”; të nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimit funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 714 prot., datë 2.11.2017, shoqëria Energji Ashta sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për licencim në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Subjekti, me shkresën (plotësim dokumentacioni) të protokolluar në ERE me nr. 714/2 prot., datë 12.12.2017, ka depozituar statutin e ndryshuar dhe ekstraktin e shoqërisë, që bën me dije se objekti i veprimtarisë së shoqërisë ka ndryshuar, duke shtuar në të aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, i cili nuk ka qenë i pasqyruar në dokumentacionin e aplikimit nr. 714 prot., datë 2.11.2017.

- Me vendimin nr. 205, datë 18.12.2017, ERE ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë Energji Ashta sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë Energji Ashta sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Energji Ashta sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

